Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
IDM

RAPORT TEMATIK

ANGAZHIMI QYTETAR NË VEPRIMTARINË PARLAMENTARE

Autor: **Megi Reçi**

SHQIPËRIA NË KUVENDIM

PËRMBLEDHJE

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) zhvilloi ushtrimin e parë në rang kombëtar të anketimit deliberativ,[1] të quajtur "Shqipëria n'Kuvendim" dhe të mbajtur në Tiranë në datat 18-21 nëntor 2021. Anketimi deliberativ mbështetet në tre anketa – një anketim me kampion përfaqësues kombëtar prej 1,200 të anketuarish, një anketim me një grup eksperimental[2] me 110 të anketuar dhe një tjetër anketë me një grup kontrolli[3] me 110 të anketuar të tjerë. Gjetjet këtij raporti tematik mbështeten tek të dhënat e anketimit kombëtar[4] si dhe në këndvështrimet e pjesëmarrësve të grupeve të vogla të diskutimit[5] të organizuara gjatë aktivitetit "Shqipëria n'Kuvendim". Anketimi kombëtar paraqet perceptimet dhe qëndrimet e shqiptarëve ndaj alternativave të mundshme për zgjidhje për një sërë çështjesh që lidhen me mbikëqyrjen parlamentare, pjesëmarrjen e qytetarëve në veprimtarinë parlamentare, demokracinë e brendshme të partive politike, sistemin zgjedhor, votën e diasporës, ndryshimet klimatike dhe imigrimin ekonomik në Shqipëri.

Nga të dhënat e anketimit kombëtar konstatohet se qytetarëve u mungon ndërgjegjësimi dhe se nuk i kuptojnë mekanizmat e angazhimit në vendimmarrje dhe kuadrin përkatës ligjor. Gjetjet nxjerrin në pah nevojën për një mjedis rregullator që bën të mundur forma të ndryshme me të cilat kanalizohet kontributi i qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së Kuvendit. Më shumë se gjysma e shqiptarëve (67.7%) e mbështetën idenë e miratimit të një kuadri ligjor të unifikuar për referendumet dhe nismat ligjore të qytetarëve dhe 56.8% mbështetën pohimin për parashikimin e një buxheti të veçantë për të mbuluar kostot e nisjes së një referendumi apo nisme ligjore qytetare. Propozimi për vendosjen e detyrimit për të organizuar referendume për çështje të rëndësishme u mbështet nga 68.2% e të anketuarve. Gjithsesi, gjatë diskutimeve në grupe të vogla në anketimin deliberativ të muajit nëntor u trajtuan edhe mangësitë në lidhje me efektivitetin e referendumeve të detyrueshme dhe koston përkatëse.

Po ashtu, 70.3% e të anketuarve mbështetën propozimin që t'u mundësohet zgjedhësve të nënshkruajnë peticione online dhe të detyrojnë Kuvendin të diskutojë për çështje të rëndësishme për publikun dhe 72% mbështetën propozimin për organizimin e konsultimeve të detyrueshme për çdo projektligj. Në diskutimet në grupe të vogla në aktivitetin "Shqipëria n'Kuvendim" u vu re mosbesimi i përgjithshëm i të anketuarve për ndikimin që mund të ketë pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrjen e Kuvendit, mosbesim i shoqëruar edhe nga perceptimi i një hendeku mes deputetëve dhe qytetarëve. Kjo u konfirmua edhe nga të anketuarit, 35.4% e të cilëve duket se i perceptojnë deputetët si të shkëputur plotësisht nga shqetësimet e qytetarëve dhe 63.7% nuk e mbështetën pohimin se njerëzit e zakonshëm kanë ndikim në punën e Kuvendit.

1 Anketimi deliberativ është një formë e veçantë e konsultimit politik ku ndërthuren teknikat e hulumtimit të opinionit publik dhe debatit publik për të zbuluar se çfarë opinioni do të kishte publiku për një çështje të caktuar nëse qytetarëve do t'u jepej një mundësi për t'u informuar më mirë. Anketimi deliberativ tenton të marrë parasysh preferencat dhe opinionet e qytetarëve para dhe pasi këta të fundit të kenë pasur mundësinë për të bërë gjykime të mirëvlerësuara bazuar në informacione të balancuara dhe pas diskutimeve me bashkëqytetarët e tjerë. Për më shumë informacioni vizitoni http://cdd.stanford.edu

2 Në grupin eksperimental bënin pjesë qytetarë të zgjedhur rastësisht nga kampioni i anketimit kombëtar, të cilët patën mundësinë të diskutonin për temat në fjalë dhe të merrnin informacione nëpërmjet materialeve informuese dhe seancave me ekspertë të pavarur gjatë një aktiviteti katër-ditor të quajtur "Shqipëria n'Kuvendim".

3 Në grupin e kontrollit bënin pjesë qytetarë të tjerë të zgjedhur rastësisht nga kampioni i anketimit kombëtar, por që nuk morën pjesë në aktivitetin katër-ditor.

4 Anketimi kombëtar u administrua nga IDM gjatë periudhës 8-18 tetor 2021.

5 Secila temë ishte objekt diskutimi për 60 minuta në tetë grupe të vogla debati e cila pasohej me një në një seancë diskutimi me ekspertë me të njëjtin minutazh.

HYRJE

Angazhimi i qytetarëve në vendimmarrje është tregues i rëndësishëm i hapësirës së shëndetshme qytetare dhe i demokracisë. Parlamenti, si një nga institucionet kyçe në një sistem me qeverisje demokratike, ka një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm për të luajtur në nxitjen e një pjesëmarrjeje të tillë duke përfshirë në vendimmarrjen e tij qytetarët që ai përfaqëson. Në Shqipëri, angazhimi i qytetarëve në procesin legjislativ është ligjërisht i mundur përmes referendumeve, nismave ligjore, peticioneve dhe konsultimeve publike.


Pavarësisht ekzistencës së kuadrit ligjor përkatës, angazhimi qytetar në vend ka pësuar rënie dhe shumë qytetarë ndjehen të privuar nga kjo e drejtë.[6] Anketimi kombëtar dhe diskutimet në aktivitetin katër-ditor të nëntorit ofruan informacione dhe këndvështrime për disa nga arsyet e mundshme të privimit të kësaj të drejte si dhe mendimin e qytetarëve për disa propozime që e adresojnë këtë situatë.

6 IDM, Gjetjet e anketimit të angazhim politik në Shqipëri 2020, gjendet në: https://idmalbania.org/survey-of-political-engagement-in-albania-2020/ ; IDM, Besimi në qeverisje 2020, gjendet në: https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/IDM-OpinionPoll-2019-AL-web-1.pdf

PREFERENCAT DHE QËNDRIMET E SHQIPTARËVE NDAJ ANGAZHIMIT QYTETAR[7]

Pjesëmarrësit e këtij anketimi u pyetën për perceptimet dhe njohuritë e tyre për angazhimin e qytetarëve në Kuvend. Kur u prezantuan me pohimin: "Njerëzit e zakonshëm kanë ndikim në punën e Parlamentit", 63.7% e të anketuarve e kundërshtuan atë dhe 24.4% ishin neutralë, ndërkohë që vetëm 11.3% ishin pro këtij pohimi dhe 0.6% u përgjigjën "nuk e di". *Shih Figurën 1*. Të anketuarit e moshës 55-64 vjeç ose ata me të ardhura mujore 70,001-100,000 lekë dhe mbi 100,001 lekë prireshin më shumë ta kundërshtonin këtë pohim. Nga ana tjetër, të anketuarit e punësuar në sektorin publik ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin krahasuar me ata të punësuar në sektorin privat.


FIGURA 1. NJERËZIT E ZAKONSHËM KANË NDIKIM NË PUNËN E PARLAMENTIT.



Përgjigjet e anketimit nxorën në pah se njohuritë e qytetarëve për kuadrin ligjor në fuqi që mundëson angazhimin e tyre në procesin legjislativ janë shumë të kufizuara. Kur u pyetën për ligjet për të drejtën e informimit, konsultimet publike, nismat ligjore qytetare dhe referendumet, 47.9% e të anketuarve thanë se nuk e dinin nëse Shqipëria kishte miratuar ligje të tilla. *Shih Figurën 2*.


7 Në këtë seksion, në analizë shkalla nga 1-10 është grupuar në tre kategori: 0-3 e kundërshtoj, 4-6 neutral, dhe 7-10 e mbështes pohimin.

FIGURA 2. SHQIPËRIA NUK KA NJË LIGJ PËR:



Në anën tjetër, të pyetur nëse Rregullorja e Funksionimit të Kuvendit u mundëson qytetarëve të marrin pjesë në mbledhjet e komisioneve të përhershme parlamentare, 29.8% e të anketuarve thanë se nuk mund të marrin pjesë, ndërsa 43.9% u përgjigjën "nuk e di". *Shih Figurën 3*. Nga këto përgjigje konstatohet mungesa e informacionit për mënyrën e ndjekjes së veprimtarisë së Kuvendit. Të anketuarit me nivel të ulët arsimor ishin më shumë të prirur të zgjidhnin alternativën "nuk e di".

FIGURA 3. SIPAS RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË KUVENDIT, A MUND TË MERRNI PJESË JU SI QYTETAR NË MBLEDHJET E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PARLAMENTARE?



Po ashtu, gjetjet e anketimit kombëtar vënë në dukje se të anketuarit e kanë të vështirë t'i kuptojnë ligjet dhe politikat publike. Plot 57.4% e të anketuarve konfirmuan se shumë çështje të politikave publike dhe ligjeve janë aq të ndërlikuara saqë njerëzit e zakonshëm e kanë të vështirë t'i kuptojnë, 26.1% ishin neutralë, 15.2% ishin kundër këtij pohimi dhe 1.3% u përgjigjën "nuk e di". *Shih Figurën. 4*.

Gjetjet e anketës kombëtare evidentuan se 67.7% e të anketuarve e mbështesnin idenë e miratimit të një ligji të unifikuar për referendumet dhe nismat ligjore qytetare, 23% ishin neutralë, 4.6% e kundërshtonin këtë propozim dhe 4.7% thanë se nuk e dinin. *Shih Figurën 5*.

FIGURA 4. SHUMË ÇËSHTJE TË POLITIKAVE PUBLIKE DHE LIGJEVE JANË AQ TË NDËRLIKUARA SAQË NJERËZIT E ZAKONSHËM E KANË TË VËSHTIRË TË KUPTOJNË SE Ç'PO NDODH.






FIGURA 5. MIRATIMI I NJË LIGJI TË UNIFIKUAR PËR REFERENDUMET DHE NISMAT LIGJORE QYTETARE



Gjatë diskutimeve në grupe të vogla në aktivitetin "Shqipëria n'Kuvendim" u vu re një dakordësi e përgjithshme nga pjesëmarrësit se referendumet do të përmirësonin demokracinë e drejtpërdrejtë dhe se nevojiteshin shembuj të suksesshëm të pjesëmarrjes së qytetarëve (referendume apo nisma ligjore) me qëllim nxitjen e angazhimit të qytetarëve.


Në diskutimet për nevojën e parashikimit të një buxheti për mbulimin e kostove të nisjes së referendumeve apo nismave ligjore qytetare, pjesëmarrësit e aktivitetit katër-ditor "Shqipëria n'Kuvendim" vunë në dukje disa problematika të mundshme, si shkurtimi i fondeve nga shërbimet publike që trajtojnë çështje më urgjente si dhe rrezikun që këto fonde të keqpërdoren. Kur u pyetën nëse e kundërshtojnë apo e mbështesin pohimin për të pasur një buxhet të veçantë nga fondet publike për të mbuluar shpenzimet e nisjes së referendumit apo nismave ligjore qytetare, 56.8% e të anketuarve e mbështetën atë, 30% u pozicionuan si neutralë, 10.2 % e kundërshtuan pohimin dhe 3% nuk shprehën mendim. *Shih Figurën 6*.

FIGURA 6. PARASHIKIMI I NJË BUXHETI (FONDE PUBLIKE) TË VEÇANTË PËR TË MBULUAR KOSTOT E NISJES SË NJË REFERENDUMI APO NISMËS LIGJORE QYTETARE.




Gjetjet e sondazhit tregojnë se 68.2% e të anketuarve mbështesin vendosjen e detyrimit për të organizuar referendume për çështje të rëndësishme. 6.2% e të anketuarve ishin kundër vendosjes së këtij detyrimi, ndërsa 23.1% ishin neutralë dhe 2.5% u shprehën se nuk e dinin. *Shih Figurën 7*. Të anketuarit e punësuar në sektorin publik prireshin më shumë ta mbështesnin këtë pohim. Në diskutimet në grupe të vogla të aktivitetit "Shqipëria n'Kuvendim", pjesëmarrësit evidentuan disa çështje të debatueshme që kanë ngjallur interes të lartë publik në vitet e fundit, si importi i armëve kimike nga Siria, shembja e Teatrit Kombëtar, mbrojtja e Lumit Vjosë përmes dhënies së statusit të parkut kombëtar, etj. Sipas disa pjesëmarrësve, organizimi i referendumeve mund të ishte i nevojshëm për rastet e lartpërmendura. Megjithatë, në lidhje me detyrimin për organizimin e referendumeve, disa pjesëmarrës u shprehën skeptikë, duke theksuar se referendumet mund të jenë të kushtueshme dhe jo efektive.

FIGURA 7. VENDOSJA E DETYRIMIT PËR TË ORGANIZUAR REFERENDUME PËR ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME.



Të pyetur për mundësimin e peticioneve online me identifikimin e votuesve si instrument me anë të të cilit qytetarët e detyrojnë Kuvendin të diskutojë për çështje të rëndësishme për publikun, 70.3% e të anketuarve ishin pro këtij pohimi, 21.9% ishin neutralë, 5.3% ishin kundër dhe 2.5% u shprehën "nuk e di". *Shih Figurën 8*. Të anketuarit e grupmoshave 25-34 vjeç ishin më shumë të prirur të mbështesnin peticionet online. Pjesëmarrësit në anketimin deliberativ "Shqipëria n'Kuvendim" argumentuan se instrumente të tilla do ta sillnin Kuvendin më pranë shqetësimeve të qytetarëve. Në lidhje me peticionet online, u vunë re disa disavantazhe, përfshirë këtu rrezikun e manipulimit të rezultateve dhe aksesin e kufizuar në një proces të tillë për të moshuarit ose qytetarët që nuk kanë akses në internet. Së fundi, referuar skandaleve të fundit që ndodhën në Shqipëri në lidhje me rrjedhjen e të dhënave personale të qytetarëve, u ngritën shqetësimet e privatësisë në lidhje me peticioneve online. Siç tha një nga pjesëmarrësit: "Ekziston rreziku i manipulimit të peticioneve online, p.sh., keqpërdorimi i të dhënave personale nga patronazhistët.[8]." U argumentua se duhen trajtuar me seriozitet rreziqet për sa i përket privatësisë dhe aksesit me qëllim që peticionet online të bëhen një mjet efikas për pjesëmarrjen e qytetarëve.


FIGURA 8. T'U MUNDËSOHET ZGJEDHËSVE QË TË NËNSHKRUAJNË PETICIONE ONLINE DHE TË DETYROJNË PARLAMENTIN TË DISKUTOJË PËR ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME PËR PUBLIKUN.



Shumica e të anketuarve (72%) mbështesnin pohimin për bërjen të detyrueshme të konsultimeve me qytetarët dhe grupet e interesit për të gjitha projektligjet, duke treguar interes të lartë për përfshirje në konsultime, ndërkohë që 21.2% ishin neutralë, 5% ishin kundër dhe 1.8% u përgjigjën "nuk e di". *Shih Figurën 9*. Të anketuarit e mirë-arsimuar ishin më të prirur për ta mbështetur këtë pohim.


8 Më 11 prill 2021, doli në media një bazë të dhënash që përmbante të dhënat personale dhe informacione private të 910,000 votuesve shqiptarë. Baza e të dhënave dyshohet se është krijuar nga Partia Socialiste në pushtet për përfitime politike. "Patronazhist" është termi i përdorur që i referohet individëve të caktuar nga partia në pushtet për të ndjekur çdo votues dhe për të regjistruar të dhënat e tyre personale në këtë bazë të dhënash kombëtare.

FIGURA 9. KONSULTIMI ME QYTETARËT DHE GRUPET E INTERESIT TË BËHET I DETYRUESHËM PËR TË GJITHA PROJEKTLIGJET, PAVARËSISHT KOSTOVE DHE KOHËS SË NEVOJSHME.



Për pyetjen sa të informuar janë deputetët për prioritetet dhe shqetësimet e qytetarëve në vend, 35.4% besojnë se deputetët nuk janë fare të informuar, ndërsa 27.7% mendojnë se janë pak të informuar për prioritetet dhe shqetësimet e qytetarëve. Pjesa tjetër e përgjigjeve u nda në "jashtëzakonisht shumë" (2.9%), "'shumë" (9,4%), "mesatarisht" (22,2%); dhe "nuk e di" (2.4%). *Shih Figurën 10*. Të anketuarit e rinj të moshës deri në 24 vjeç ishin më të prirur ta perceptonin këtë distancë mes shqetësimeve të qytetarëve dhe deputetëve.

FIGURA 10. SA TË INFORMUAR MENDONI SE JANË DEPUTETËT PËR PRIORITETET DHE SHQETËSIMET E QYTETARËVE NË VEND?



Nga ana tjetër, 67.9% e të anketuarve nuk ishin dakord me pohimin se "Deputetët dhe politikanët i kushtojnë shumë vëmendje mendimit të njerëzve të zakonshëm", ndërkohë që vetëm 9.9% ishin pro këtij pohimi, 21.6% ishin neutralë dhe 0.6% u përgjigjën se "nuk e dinin". *Shih Figurën 11*. Gratë, të papunët dhe studentët ishin më shumë të prirur ta kundërshtonin këtë pohim.

Kur vjen puna te angazhimi i drejtpërdrejtë me deputetët apo politikanët qoftë fizikisht, me shkrim apo forma të tjera, të anketuarit nuk u shprehën të gatshëm për një gjë të tillë dhe vetëm 12.6% thanë se ishin "jashtëzakonisht të gatshëm". Pjesa tjetër e të anketuarve u ndanë në përgjigjet: "shumë i gatshëm" (21.6%), "mesatarisht i gatshëm" (20.6%), "pak i gatshëm" (18.9%), "aspak i gatshëm" (23.9%) dhe "nuk e

di" me 2.4%. *Shih Figurën 12*. Të dhënat tregojnë se gratë janë më pak të gatshme të kontaktojnë drejtpërdrejtë me deputetët në krahasim me burrat.

FIGURA 11. DEPUTETËT DHE POLITIKANËT I KUSHTOJNË SHUMË VËMENDJE MENDIMIT TË NJERËZVE TË ZAKONSHËM.





FIGURA 12. SA TË GATSHËM DO TË ISHIT PËR TË KONTAKTUAR ME POLITIKANË OSE DEPUTETË QOFTË FIZIKISHT, QOFTË ME SHKRIM APO NË FORMA TË TJERA?



METODOLOGJIA


Për anketimin kombëtar u përdor një kampion përfaqësues i popullsisë shqiptare, ku të anketuarit u zgjodhën në mënyrë rastësore nga të gjitha bashkitë dhe njësitë administrative të vendit. Përdorimi i një kampioni të ponderuar përfaqësimi kombëtar na bën të mundur që gjetjet t'i aplikojmë për të gjithë popullsinë në vend. Si rrjedhim, niveli i rëndësisë statistikore të kampionit përshkruhet si vijon: për një popullatë shqiptare rezidente në moshë madhore prej 2,220,569 , me një madhësi kampioni prej 1,200 të anketuarve, për një nivel besimi 95%, intervali i besimit është ± 2,83; dhe për një nivel besimi prej 99%, intervali i besimit është ± 3,72.

Për të përcaktuar madhësinë e kuotës së secilit prej qarqeve të vendit, numri i popullsisë së Shqipërisë u mor nga regjistri civil, ndërsa numri i banorëve për secilin qark në 1 janar 2021 u mor nga Instituti i Statistikave (INSTAT). Edhe pse se numri i banorëve në moshën mbi 18 vjeç ndryshonte me vetëm 0,31% mes viteve 2019 dhe 2021, ky ndryshim nuk ndikoi statistikisht në madhësinë e kampionit sipas qarkut dhe në intervalin e besimit të përmendur më sipër. Kampioni prej 1,200 të anketuarish u shpërnda në të 61 bashkitë e 12 qarqeve të vendit. Më pas, shpërndarja sipas qarkut u përshtat për të zgjedhur vetëm popullsinë në moshë madhore (mbi 18 vjeç) dhe për të përdorur kontrolle kuotash për gjininë. Duke qenë se INSTAT nuk i përcakton grupmoshat nën 18 vjeç ose mbi 18 vjeç, është përdorur teknika e interpolimit linear. Më pas, kjo përzgjedhje u ponderua sipas grupmoshave më të fundit të publikuara nga INSTAT (në kohën kur u hodh shorti), që ishin të dhënat për vitin 2020. Rezultatet e përllogaritura dhe të publikuara në këtë analizë janë ponderuar sipas dy dimensioneve: shpërndarja gjeografike e popullsisë dhe grupmosha.


DEMOGRAFIA E TË ANKETUARVE

Në total morën pjesë në anketimin kombëtar 1,200 qytetarë shqiptarë të moshës 18 vjeç e sipër nga të gjitha bashkitë e Republikës së Shqipërisë. Nga ky kampion me përfaqësim kombëtar, 55.1% ishin meshkuj dhe 44.9% ishin femra. Pjesa më e madhe e të anketuarve i përkiste grupmoshave që varionin nga 18 vjeç në 54 vjeç (63.9%). Të anketuarit e moshës 55 vjeç dhe më shumë përbënin vetëm 36.1% të të gjithë kampionit përfaqësues. Lutemi referojuni grafikëve të mëposhtëm për më shumë hollësi në lidhje me shpërndarjen sipas moshës së kampionit.

MOSHA




GJINIA




Shpërndarja gjeografike ishte 68.6% urbane dhe 31.4% rurale. Si për krahasim, të dhënat e Institutit të Statistikave (INSTAT) thonë se në vitin 2011, 58.2% e popullsisë rezidente shqiptare banonte në zonat urbane.[9] Megjithatë, gjatë dhjetë viteve të fundit, ky numër është rritur.

VENDBANIMI



Pjesa më e madhe e të anketuarve (70.8%) kishin një diplomë të shkollës së mesme ose kishin diplomë universitare apo pasuniversitare, ku 43.1% e tyre kishin përfunduar arsimin e mesëm (d.m.th., kishin diplomë të shkollës së mesme), ndërsa 27.7% kishin marrë diplomë universitare ose pasuniversitare. Plot 28.2% e të anketuarve kishin arsim të mesëm të ulët, ku 19.6% e të anketuarve kishin përfunduar programin e detyrueshëm 8/9-vjeçar, ndërsa 8.6% nuk kishin përfunduar asnjë nivel arsimor ose kishin vetëm arsim fillor (4/5 klasë shkollë).


NIVELI ARSIMOR




9 http://www.instat.gov.al/media/2919/a_new_urban-rural_classification_of_albanian_population.pdf

Rreth 46.9% e të anketuarve ishin të punësuar në kohën e anketimit, teksa 72.4% e tyre punonin në sektorin privat dhe 27.6% ishin të punësuar në sektorin publik. Rreth një e pesta e të anketuarve deklaruan se ishin të papunë (19.3%), ndërsa 6% ishin studentë, 20.9% në pension dhe 5.4% zgjodhën përgjigjen alternative "tjetër".

STATUSI I PUNËSIMIT




SEKTORI I PUNËSIMIT



Për sa i përket nivelit të të ardhurave të rregullta mujore individuale të të anketuarve, 22.5% e të tyre deklaruan se nuk kishin të ardhura të rregullta në kohën e anketimit, 33,2% fitonin deri në 30,000 lekë/muaj, ndërsa 21,2% raportuan se merrnin të ardhura të rregullta mujore që varionin nga 30,001 lekë në 50,000 lekë. Vetëm 14.2% e të anketuarve thanë se kishin të ardhura mujore individuale mbi 50 mijë lekë.

NIVELI I TË ARDHURAVE TË RREGULLTA MUJORE INDIVIDUALE (NETO)



Tiranë, Shkurt 2022
© 2022 nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)
Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, Nd. 35, H.1
1017 Tirana, Albania
E-mail: info@idmalbania.org
Website: www.idmalbania.org

SHËNIM

Ky raport tematik u përgatit nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Pikëpamjet dhe përfundimet që jepen në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Autorësia e këtij botimi i përket vetëm IDM-së. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo lloj forme ose me çfarëdo lloj mjeti pa lejen paraprake me shkrim të IDM-së.

Mbështetje për Parlamentin
dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri

NJË PROJEKT NGA

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

"Mbështetje për Parlamentin dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri" (PACEP), është një projekt nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Prezenca e OSBE në Shqipëri dhe Instituti Demokratik Amerikan (NDI)."

ZBATUAR NGA

NDI
NATIONAL DEMOCRATIC INSTITUTE

PARTNERË NË ZBATIM

IDM
Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Ky aktivitet u zhvillua nga IDM në kuadër të projektit PACEP, në konsultim me Qendrën për Demokraci Deliberative pranë Universitetit të Stanford (ShBA).